



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.601/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-18457-06-23-2017, me objekt : “*Sistemi Wi-Fi per qytetin, shkollat dhe qendra te populluara te njesive administrative*”, me fond limit 12 279 042 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 24.07.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Malësi e Madhe.

Ankimues:

“Albtelecom” sha
Autostrada Tiranë Durrës, Km. 7, Kahar

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Malësi e Madhe
Koplik, Malësi e Madhe

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.06.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-18457-06-23-2017, me objekt: “Sistemi Wi-Fi per qytetin, shkollat dhe qendra te populluara te njesive administrative”, me fond limit 12 279 042 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 24.07.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Malësi e Madhe.

II.2. Në datën 03.07.2017, operatori ekonomik ankimues “Albtelecom” sha, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...]

Në DT, në pikën 3.3.. Kapaciteti teknik është kërkuar:

3.3.1 Ofertuesi duhet te jete i pajisur me Certifikate:

ISO 9001:2008

ISO 20000-1:2011

ISO 27001:2013

Certifikatat duhet te jene ne gjuhen e ofertes, dhe ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen.

Lidhur me këtë kërkesë dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj sqarimin si më poshtë:

Albtelecom si operator telekomunikacionesh është një kompani e madhe dhe shumëvjecare në treg e cila operon në ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit si për klientët fundorë ashtu dhe për klientët që operojnë si ofertues shërbimesh në tregun vendas konform legjislacionit në fuqi dhe autorizimeve të përgjithshme dhe individuale të lëshuara nga AKEP. Albtelecom disponon të gjitha licencat e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti përfshirë këtu edhe certifikatën ISO 9001:2008; ISO 27001; dhe ISO 20001”2011.

Certifikata ISO 9001:2008 është një certifikatë ndërkombëtare e cila i leshohet oe dhe ka për qëllim certifikimin e cilësisë së sistemeve të menaxhimit. Kompania Albtelecom është pajisur me këtë certifikatë për të vërtetuar cilësinë e sistemeve të menaxhimit në lidhje me shërbimin e telefonisë fikse dhe celulare, shërbimin e internetit të teknologjisë fikse dhe atë të lëvizshme, shërbimin IP TV etj.

Certifikata ISO 27001 është certifikatë ndërkombëtare e cila i leshohet një oe dhe ka për qëllim certifikimin e sistemeve të sigurisë së menaxhimit të informacionit. Kompania Albtelecom është pajisur me këtë certifikatë për të vërtetuar sigurinë e sistemeve të menaxhimit të informacionit në lidhje me shërbimin e telefonisë fikse dhe celulare, shërbimin e internetit dhe teknologjinë fikse dhe atë të lëvizshme, shërbimin IP TV etj.

Certifikata ISO 20001:2011 është certifikatë ndërkombëtare e cila i leshohet një operatori dhe ka për qëllim certifikimin e menaxhimit të teknologjisë së Informacionit. Kompania Albtelecom është pajisur me këtë certifikatë për të vërtetuar sigurinë e sistemeve të projektimit inxhinierisë shitjes dhe ofrimit të pajisjeve dhe sistemeve të shërbimeve të telekomunikacionit IT Elektronike.

Në lidhje me certifikatën ISO 22301:2012 kompania Albtelecom dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj se kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit duke mos qënë e nevojshme për një operator telekomunikacioni dhe se kjo kërkesë është vendosur qëllimisht për të favorizuar një kompani të vetme e cila e disponon.

Certifikata ISO 22301:2012 është një certifikatë e cila ka për qëllim menaxhimin e sistemit të vazhdimësisë së biznesit. Kërkesa e licencës ISO 22301:2012 bie në kundërshtim me kërkesat e specifikuara në tender, ku përcaktohet disponueshmëria e sistemit dhe jo vazhdimësia e tij.

Albtelecom është një kompani lider në fushën e telekomunikacionit, dhe ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme për implementimin e projekteve të kësaj natyre dhe madhësie dhe nuk është e pranueshme të diskriminohet nga mospjesmarrja në tender për mungesën e kësaj certifikate. Albtelecom është provideri më i madh i internetit në Shqipëri dhe e ka implementuar dhe menaxhuar me sukses shumë projekte të ngjashme. Kompania Albtelecom thekson dhe një herë se kërkesa juaj si kërkesë diferencuese dhe

diskriminuese duke i krijuar hapësira dhe mundësi bashkëpunimi një operatori të vetëm me anë të këtij kriteri, dhe theksojmë se nuk është pjesë esenciale dhe e domosdoshme për mundësinë e ofrimit të shërbimit të kërkuar nga ana juaj.

Në DT në pikën 3.3.3 është kërkuar:

Një punësim mesatar jo me pak se 8 (tete) punonjes, për periudhën Janar 2016 – Prill 2017

Ndër këto punonjës duhet të ketë të paktën

I. 1 (nje) punonjes te diplomuar ne nje nga deget e teknologjise dhe informacionit, dhe te zoteroje kualifikime si:

- a. Microsoft Certified Solution Developer
- b. Microsoft Certified Application Developer
- c. Microsoft Certified Database Administrator
- d. Microsoft Certified System Engineer

II. 2 (dy) punonjes (senior developer) inxhinierë IT :

- a. me eksperience ne zhvillimin e softëare
- b. te certifikuar si Microsoft Certified Profesional
- c. te certifikuar si ASP.NET MVC ËEB Applications Developer

Punonjesit e tjere te provohen si me lart qe jane pjese e kompanise dhe te kene kualifikimin e nevojshem duke paraqitur certifikaten Microsoft Certified Profesional.

Lidhur me këtë kërkesë dëshirojmë të sjellim në vëmendjen sqarimin si më poshtë:

Në vijim të kërkesës së mësipërme Albtelecom konfirmon se është një kompani e licencuar nga autoriteti më i lartë që operon në vend sic është AKEP dhe për këtë disponon të gjithë licencat e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti. Certifikatat e kërkuara më sipër nuk i shërbejnë qëllimit kryesor të tenderit i cili është krijimi i një rrjeti të dhënash . I gjithë sistemi i kërkuar është kryesisht i ofruar nga prodhuesi në formën me “celësa në dorë”. Objekti i shërbimit të kërkuar në tender është kryesisht infrastrukturërrjeti dhe ËI FI dhe jo sisteme Microsoft.Të gjithë softëaret apo faqet e aplikimit janë pjesë integrale e zgjidhjes të ofruara nga prodhuesi. Certifikimet e mësipërme nuk janë të nevojshme dhe realisht nuk sjellin një vlerë të shtuar në shërbimin objekt prokurimi. Përsa më sipër kompania Albtelecom thekson dhe njëherë se kërkesa juaj është kërkesë diferencuese dhe diskriminuese duke krijuar hapsira dhe mundësi bashkëpunimi një operatori të vetëm me anë të këtij kriteri e cila theksojmë se nuk është pjesë esenciale dhe e domosdoshme për mundësinë e ofrimit të shërbimit të kërkuar nga ana juaj. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatat dhe ofertuesit

dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Ne do tju luteshim që të rishikoni dhe njëherë këtë kërkesë duke krijuar mundësi për pjesmarrje dhe bashkëpunim dhe për kompanitë e tjera që operojnë në tregun shqiptar.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit pika 3.4

3.4 Ofertuesi duhet te zoteroje status partneriteti me Microsoft GoldApplication Development dhe te provohet nepermjete certifikatave/marreveshjeve te leshuara nga prodhuesi.

Lidhur me këtë kërkesë dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj sqarimin si më poshtë:

Tenderi po orientohet kryesisht drejt një prodhuesi aplikacionesh si microsoft sesa një prodhuesi infrastrukture. Vetë Microsoft nuk prodhon këto sisteme dhe të qënurit partner nuk është kusht i cili i shërben qëllimit finalizimit me sukses të këtij projekti. Nga sa më sipër Albtelecom kërkon: Rishikimin e këtyre kriterëve të kualifikimit dhe vlerësimit në përputhje me LPP-në duke krijuar mundësi të barabarta për pjesmarrje dhe bashkëpunim për të gjithë kompanitë që operojnë në tregun Shqiptar.

II.3. Autoriteti Kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues brenda afateve të përcaktuara në LPP.

II.4. Në datën 14.07.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në datën 20.07.2017, nëpërmjet shkresës me nr.3120 prot., datë 20.07.2017, protokolluar me tonën nr. 1280/2prot., datë 21.07.2017 me objekt: “Dërgim Informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Albtelecom” sha.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për certifikatat se “Në lidhje me certifikatën ISO 22301:2012 kompania Albtelecom dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj se kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit duke mos qënë e nevojshme për një operator telekomunikacioni dhe se kjo kërkesë është vendosur qëllimisht për të favorizuar një kompani të vetme e cila e disponon.

Certifikata ISO 22301:2012 është një certifikatë e cila ka për qëllim menaxhimin e sistemit të vazhdimësisë së biznesit. Kërkesa e licencës ISO 22301:2012 bie në kundërshtim me kërkesat e specifikuara në tender, ku përcaktohet disponueshmëria e sistemit dhe jo vazhdimësia e tij.

Albtelecom është një kompani lider në fushën e telekomunikacionit, dhe ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme për implementimin e projekteve të kësaj natyre dhe madhësie dhe nuk është e pranueshme të diskriminohet nga mospjesmarrja në tender për mungesën e kësaj certifikate. Albtelecom është provideri më i madh i internetit në Shqipëri dhe e ka implementuar dhe menaxhuar me sukses shumë projekte të ngjashme. Kompania Albtelecom thekson dhe një herë se kërkesa juaj si kërkesë diferencuese dhe diskriminuese duke i krijuar hapësira dhe mundësi bashkëpunimi një operatori të vetëm me anë të këtij kriteri, dhe theksojmë se nuk është pjesë esenciale dhe e domosdoshme për mundësinë e ofrimit të shërbimit të kërkuar nga ana juaj”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 7 Kriteret e vecanta të kualifikimit “Kapaciteti Teknik”, pika .3.3., është kërkuar:

“Ofertesi të ketë minimalisht certifikatat e mëposhtme:

Certifikatë ISO 14001:2004 (e vlefshme) (Certifikon që Sistemi i Menaxhimit Mjedisor për 3.3.1

Ofertuesi duhet të jete i pajisur me

Certifikate: ISO 9001:2008

ISO 20000-1:2011

ISO 27001:2013

ISO 22301:2012



Certifikatat duhet të jene ne gjuhen e ofertes, dhe ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen.

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, geramat “a” e “b” e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.1.3. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të

pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”.

III.1.4. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2 përcaktohet:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.
2. Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.1.6. ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standardeve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrueshëm me avantazhe reciproke.

Çertifikata ISO 22301:2012 (e kërkuar nga autoriteti në DT) është një standard që rregullon Sistemet e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të volumit dhe të kontratës së prokurimit, autoriteti kontraktor harton dhe përcakton dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim.

Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar edhe në dokumentacionin e kësaj procedure prokurimi, objektit të kontratës të publikuar nga autoriteti kontraktor, gjykon se kërkesa për ISO 22301:2012, është një kërkesë e ekzgjerruar dhe jo në përpjesëtim të drejtë me volumin e kontratës, objektin e prokurimit dhe elementët e shërbimit të parashikuara në dokumentat e tenderit, duke vlerësuar se nuk është e nevojshme

kërkesa për paraqitjen e një dokumenti të tillë e si rrjedhim pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për certifikatë ISO 22301:2012 qëndron.

Akoma më tej, sqarojmë se autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur fakte dhe argumenta se pse është e nevojshme përcaktimi i kriterëve të tilla, duke krijuar bindjen se përcaktimi i kriterëve të tilla është diskriminues dhe jo në përputhje me objektin dhe natyrën e prokurimit, të tilla që çojnë në pengimin dhe kufizimin e konkurrencës së lirë si edhe të pjesëmarrjes së gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës duke i hequr kriterin për certifikatë ISO 22301:2012.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për pajisjen e punonjësve me kualifikimet “Në DT në pikën 3.3.3 është kërkuar:

Një punësim mesatar jo më pak se 8 (tete) punonjës, për periudhën Janar 2016 – Prill 2017

Ndër këto punonjës duhet të ketë të paktën

I. 1 (nje) punonjës të diplomuar në një nga degët e teknologjisë dhe informacionit, dhe të zotërojnë kualifikime si:

- a. Microsoft Certified Solution Developer*
- b. Microsoft Certified Application Developer*
- c. Microsoft Certified Database Administrator*
- d. Microsoft Certified System Engineer*

II. 2 (dy) punonjës (senior developer) inxhinierë IT :

- b. me eksperience në zhvillimin e softëare*
- c. të certifikuar si Microsoft Certified Profesional*
- d. të certifikuar si ASP.NET MVC ËEB Applications Developer*

Punonjësit e tjerë të provohen si më lart që janë pjesë e kompanisë dhe të kenë kualifikimin e nevojshëm duke paraqitur certifikatën Microsoft Certified Profesional. Lidhur me këtë kërkesë dëshirojmë të sjellim në vëmendjen sqarimin si më poshtë:

Në vijim të kërkesës së mësipërme Altelecom konfirmon se është një kompani e licencuar nga autoriteti më i lartë që operon në vend sic është AKEP dhe për këtë disponon të gjithë licencat e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti. Certifikatat e kërkuara më sipër nuk i shërbejnë qëllimit kryesor të tenderit i cili është krijimi i një rrjeti të dhënash . I gjithë sistemi i kërkuar është kryesisht i ofruar nga prodhuesi në formën me “celësa në dorë”. Objekti i shërbimit të kërkuar në tender është kryesisht

infrastrukturërrjeti dhe EIFI dhe jo sisteme Microsoft. Të gjithë softëaret apo faqet e aplikimit janë pjesë integrale e zgjidhjes të ofruara nga prodhuesi. Certifikimet e mësipërme nuk janë të nevojshme dhe realisht nuk sjellin një vlerë të shtuar në shërbimin objekt prokurimi. Përsa më sipër kompania Albtelecom thekson dhe njëherë se kërkesa juaj është kërkesë diferencuese dhe diskriminuese duke krijuar hapsira dhe mundësi bashkëpunimi një operatori të vetëm me anë të këtij kriteri e cila theksojmë se nuk është pjesë esenciale dhe e domosdoshme për mundësinë e ofrimit të shërbimit të kërkuar nga ana juaj. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatat dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Ne do tju luteshim që të rishikoni dhe njëherë këtë kërkesë duke krijuar mundësi për pjesmarrje dhe bashkëpunim dhe për kompanitë e tjera që operojnë në tregun shqiptar.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 7 Kriteret e vecanta të kualifikimit “Kapaciteti Teknik”, pika .3.3.3., është kërkuar:

Në DT në pikën 3.3.3 është kërkuar:

Një punësim mesatar jo me pak se 8 (tete) punonjes, për periudhën Janar 2016 – Prill 2017

Ndër këto punonjës duhet të ketë të paktën

I. 1 (nje) punonjes te diplomuar ne nje nga deget e teknologjise dhe informacionit, dhe te zoteroje kualifikime si:

- a. Microsoft Certified Solution Developer
- b. Microsoft Certified Application Developer
- c. Microsoft Certified Database Administrator
- d. Microsoft Certified System Engineer

II. 2 (dy) punonjes (senior developer) inxhinierë IT :

- e. me eksperience ne zhvillimin e softëare
- f. te certifikuar si Microsoft Certified Profesional
- g. te certifikuar si ASP.NET MVC EEB Applications Developer

Punonjesit e tjere te provohen si me lart qe jane pjese e kompanise dhe te kene kualifikimin e nevojshem duke paraqitur certifikaten Microsoft Certified Profesional.

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, geramat “a” e “b” e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet

të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorhet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.2.3. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”.

Në nenin 28 pika 2 “Kontratat shërbimeve” të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë nëpërpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Në nenin 28, pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në”.

III.2.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.2.5. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se çertifikatat e vendosura nga autoriteti kontraktor në pikën 3.3.3. të “Kapacitetit teknik” konkretisht: “*Microsoft Certified Application Developer*”- Zhvillues aplikacione të çertefikuara nga Microsofti; “*Microsoft Certified Database Administrator*”- Të çertefikuara nga Microsoft për administrator Database; “*Microsoft Certified System Engineer*”- Të çertefikuara nga Microsoft si inxhinier për sistemet të ndryshme; “*Microsoft Certified Profesional*”- Profesionist i çertefikuara nga Microsoft; “*ASP.NET Web Applications Developer*”- Të çertefikuara nga asp.net për zhvillim website janë çertifikata të certifikuara nga nga një kompani në rastin konkret nga Microsoft, por nuk janë çertifikata të cilat vërtetojnë qëllimin kryesor të objektit të prokurimit. Akoma më tej referuar objektit të prokurimit konkretisht qëllimit të projektit që konsiston në ngritjen e një rrjeti WI-FI, çertifikatat e mësipërme nuk e mbulojnë këtë fushë. Në këtë kuptim referuar specifikimeve teknike më saktësisht objektivave (rezultatit) që do të arrihet nga kontraktuesi, krijimi i një infrastrukture të tillë rrjeti nuk mbulohet nga çertifikatat e kërkuara në kriterin e veçantë të kualifikimit. Komisioni i prokurimit Publik gjykon se çertifikat e mësipërme të vendosura nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit orientojnë drejt zgjidhjeve Microsoft, çka kufizon pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë të mundshëm pjesmarrës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës duke i hequr kriterin për çertifikatat e mësipërme.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për statusin e partneritetit se “Në kriteret e vecanta të kualifikimit pika 3.4

3.4 Ofertuesi duhet të zotëroj status partneriteti me Microsoft GoldApplication Development dhe të provohet nepermjet çertifikatave/marreveshjeve të leshuara nga prodhuesi.

Lidhur me këtë kërkesë dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj sqarimin si më poshtë:

Tenderi po orientohe kryesisht drejt një prodhuesi aplikacionesh si microsoft sesa një prodhuesi infrastrukture. Vetë Microsoft nuk prodhon këto sisteme dhe të qënurit partner nuk është kusht i cili i shërben qëllimit finalizimit me sukses të këtij projekti.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 7 Kriteret e vecanta të kualifikimit “Kapaciteti Teknik”, pika .3.4, është kërkuar:

3.4 Ofertuesi duhet të zotëroj status partneriteti me Microsoft GoldApplication Development dhe të provohet nepermjet çertifikatave/marreveshjeve të leshuara nga prodhuesi.

III.3.2. Në nenin 46, pika 1, gjerat “a” e “b” e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurrohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.3.4. Referuar objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, termave të referencës të parashikuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se disponimi nga ana e operatorëve ekonomikë të statusit “[...]partneriteti me Microsoft GoldApplication Development [...]”, del jashtë objektit të prokurimit që kërkon të realizojë autoriteti kontraktor. Akoma më tej Komisioni sqaron se referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

[...]

Në këtë kuptim referuar bazës ligjore, si dhe natyrës së objektit të prokurimit, autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e kriterit të sipërcituar duke e hequr kriterin për « statutsin e partneritetit me Microsoft GoldApplication Development », pasi ky kriter kufizon pjesëmarrjen duke ulur konkurrencën e operatorëve ekonomikë të mundshëm pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albtelecom” sha për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-18457-06-23-2017, me objekt: “*Sistemi Wi-Fi per qytetin, shkollat dhe qendra te populluara te njesive administrative*”, me fond limit 12 279 042 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 24.07.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Malësi e Madhe.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albtelecom” sha
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1280 Protokolli, Datë 14.07.201

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi